

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Riparim i linjës kabllore L 110 4/2a Traktora-Farkë”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

31321000-2 - Linja të energjisë elektrike.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

13,196,731.98 (trembëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një pikë nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 13,000,000 (trembëdhjetë milion) Lekë.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate punimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros duhet te jete ne masen 13,000,000 (trembëdhjetë milion) Leke.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.3.1 Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 6,500,000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 26,000,000 (njëzet e gjashtë milion) lekë pa TVSH.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kërkuara, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë sipas parashikimeve ligjore. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Gjithashtu, duke patur në vëmendje punën e vështirë dhe llojin e vecantë që duhet të bëjë OE në realizimin e kësaj kontrate, AK kërkon me doemos që OE ofertues t’i ketë një përvojë të ngjashme të kësaj natyre.

---

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale, në fushën e zbatimit të punimeve, lëshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

Punime të përgjithshme ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime germimi në tokë	Klasifikim A
Kategoria NP-11	Ndertime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesme dhe shpërndarjen e energjisë	Klasifikim A

**Shenim:** Në rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategoritë e pershkruara, duhet ta ketë të njehsuar pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.

**Argumentimi:** Këto kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e

kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

VENDIM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

- N.P. 1 Punime gërmimi në tokë, Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.  
(Bazuar ne llogaritjet analitike rezulton Klasifikimi A , 0-20 milion lekë)
- N.P. 1 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.  
Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

(Bazuar ne llogaritjet analitike rezulton Klasifikimi A , 0-20 milion lekë)

*2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale duhet te kete te punesuar te pakten 1 (nje) drejtues teknik/inxhinier elektrik.*

*Drejtuesi teknik duhet te jetë i siguruar dhe te figuroje ne listepagesat perkatese E-Sig per 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratën individuale te punes, shoqeruar me diplomën perkatese te inxhinierit te mesiperm, deshmi IQT, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kërkesa për inxhinierin e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e një inxhinieri elektrik si drejtues teknik siguron që puna do të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe me kujdesin e duhur për sigurinë e punonjësve dhe të mjedisit. Ky kriter ndihmon në garantimin e cilësisë së punëve. Inxhinieri elektrik si drejtues teknik është përgjegjës për monitorimin e punimeve dhe menaxhimin e situatave teknike që mund të dalin gjatë zbatimit.

*2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 4 (kater) punonjës, nga të cilët 1 (një) punëtor i thjeshtë me kohë të plotë pune, 2 (dy) specialiste me kohë të plotë pune, dhe 1 (një) shofer manovrator për realizimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet të jene të siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

*Shënim: Punonjësi i kërkuar 1 (një) shofer manovrator, mund të disponohet edhe me kontratë shërbimi, nëse nuk është pjese e stafit të OE ofertues.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjësve është përlogaritur duke patur në konsideratë volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ne mbështetje të VKM Nr. 216 date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualeve të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” është hartuar analitikisht preventivi me ore pune nga I cila ka dalë numri përkatës i stafit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës brenda afatit 1 muaj.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 2 (dy) punonjes, te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, nga te cilet 1(nje) te jete punonjes me kategorine e sigurimit teknik IV-V, te leshuar nga shoqeri te akredituara ne baze te Ligjit Nr. 8734, date 01.02.2001, “Per garantimin e sigurise se punes te pajisjeve dhe te instalimeve elektrike”, i ndryshuar, “Rregullore e sigurimit dhe shfrytezimit teknik per impjantet, paisjet dhe instalimet elektrike”.*

*Lidhur me kete pike, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:*

- i. Listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar si dhe*
- ii. Kartelat perkatese te vlefshme te sigurimit teknik.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kërkesa për specialistët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ne “Rregullore e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik per impjantet, paisjet dhe instalimet elektrike”citohet: Personeli qe punon dhe shërben ne instalimet dhe impjantet elektrike duhet te plotesoje këto kushte : b) te kete mësuar te punoje pa rezik ne pune nen drejtimin e nje punonjësi me pervoje, te dije rregullat ne masën e detyrës qe i ngarkohet ose te punës qe kryhen , te kaloje ne provim nga komisioni kualifikues per te fituar grupin e kualifikimit te sigurimit teknik( sipas tabelës se kualifikimit qe jepet ne Shojcen Nr.2) dhe te kete librezën e sigurimit teknik ( dëshmi), 1-4 Personi qe nuk ploteson qofte dhe nje nga kushtet e mesiperme, ndalohet te ushtroje punen. Sipas kesaj rregulloreje kryerja e punimeve behet me flete pune. Per punimet pa rezik ne linje , personi qe hap kete flete pune duhet te jete drejtues punimesh dhe te te kete kategorinë IV e larte te sigurimit teknik.

Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues per përmbushjen e kontratës duhet te dëshmoj se ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme, si me poshte vijon:*

Nr.	Mjetet	Sasia
-----	--------	-------

1	Autovinc deri në 5 ton	1 cope
2	Eskavator 0.25 m <sup>3</sup>	1 cope
3	Auto Vetshkarkuese	1 cope

*Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:*

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm).*
- b) *Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) si dhe leje transporti, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Mjetet dhe pajisjet teknike te vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit te kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen në kantier. Kjo kërkesë është minimale dhe jodiskriminuese në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe pika 6/d, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Ne mbeshetjete te VKM Nr. 216 date 13.04.2023 “Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualeve te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim” jemi bazuar ne zerat dhe analizat teknike per percaktimin e mjeteve dhe pajisjet teknike te nevojshme.

- Autovinc deri në 5 ton perfshihet ne analizen e zerit :F.V. xhunto ( muftë bashkuese e drejte) te kablllove te TL 110 kV, AL, seksioni 1x800 mm<sup>2</sup>
- Eskavator 0.25 m<sup>3</sup> perfshihet ne analizen e zerit 3.88/a , Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke, 3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet

- Auto Vetshkarkuese perfshihet ne analizen e zerit 2.37/5b Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate qe mallrat e furnizuara jane te reja (jo te rikonstruara).*

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me pikën 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe kane lidhje me objektin e prokurimit, si me poshte:*

- ✓ *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.*
- ✓ *ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.*
- ✓ *ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit mjedisor.*

**Argumentimi:** Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

**Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:** është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

**Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:** është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecante për kryerjen e kesaj kontrate. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi duhet të kryejë punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet që mund të shfaqen gjatë realizimit të kesaj kontrate.

**Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001:** e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues është i certifikuar për produkte të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.9 *Per listen e meposhtme te mallrave:*

- ✓ *Mufte bashkuese per kabllot (sipas specifikimeve teknike)*
- ✓ *Kabllo fuqie 110 kV, me izolim XLPE, (1x800) mm<sup>2</sup>*

*Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:*

1. *Autorizim te prodhuesit/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.*

*Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese te katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

**Argumentimi:** Në lidhje me kriterin për listën e mallrave që do të përdoren, nisur nga rëndësia e madhe e projektit dhe funksioni që ato do të kryejnë në realizimin e objektit të kontratës, si dhe nga vlera e tyre, u mendua që ky kriter të mundësojë sigurimin e mallrave cilësore me parametra që plotësohen nga prodhues të certifikuar për menaxhimin e cilësisë së mallrave. Ky kriter është në proporcion me vlerën e kontratës, është jodiskriminues dhe i mundshëm të përmbushet nga cdo operator që ka përvojë në këtë fushë objekt kontrate.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.12 *Operatori ekonomik ofertues duhet te plotesoje saktesisht kolonen me te dhenat teknike te ofertuar ne te gjitha tabelat e paraqitura ne Shtojcen 5 (Specifikimet teknike) te ketyre DT-ve, ku kerkohet.*

***Mosplotesimi i sakte eshte element skualifikimi.***

**Argumentimi:** Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njëh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

*2.3.13 Ne funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Ates, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.*